



Rrëfëhet se një njeri kishte

probleme të mëdha, andaj, si shkak i tyre, kishte rënë në depresion. Duke qenë se nuk mund të gjente një zgjidhje për problemet, kishte vendosur të këshillohej me një të urtë, andaj kishte shkuar tek ai dhe i kishte thënë:

O njeri i mençur! Kam ardhur për tu konsultuar për disa problem, prej të cilave nuk po mund të dal!

Atëherë, më lejo të të pyes diç! –ia ktheu njeriu i urtë.

A ke ardhur në këtë botë me këto probleme?! A ke lindur me to?! –e pyeti.

Jo –iu përgjigj ai.

Kur do të vdesësh, do t'i marrësh këto probleme me vete apo do t'i braktisësh në këtë botë? –e pyeti prapë.

Jo –ia ktheu ai.

Një punë, që nuk ka lindur bashkë me ty dhe as që do të të shoqërojë pasi ta braktisësh këtë botë, nuk meriton të ta shkaktojë tërë këtë stres. Bëhu durimtar në çështjet e kësaj bote, dhe, nëse dëshiron të realizosh ambiciet tua, atëherë shikimi yt le të fokusohet më shumë në qiell (botën tjetër) se sa në tokë (këtë botë).

Njeriu doli i gëzuar nga shtëpia e këtij të urti ndërsa përsëriste: Një punë që nuk ka lindur me ty dhe nuk vjen me ty pas vdekjes, nuk meriton tërë këtë shqetësim!

Përshtati: [Sedat ISLAMI](#)